



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura VI
Sesioni pranveror

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal
Mbledhja nr.64/2019
Prishtinë, më 21.5.2019, në orën 12:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Sala Berisha Shala, kryetare, Dardan Sejdiu, zëvendëskryetar i parë, Memli Krasniqi, Muharrem Nitaj, Veton Berisha dhe Duda Balje, anëtarë.

Munguan: Adem Hoxha, zëvendëskryetar i dytë, Hykmete Bajrami, Lutfi Zharku, Glauk Konjufca dhe Liburn Aliu, anëtarë.

Të ftuar: Musa Shabani, kryesues i Bordit të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPMM); Adem Ahmetaj, Ministria e Zhvillimit Ekonomik - MZHE (Njësia për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike – NJPMNP).

Pjesëmarrës të tjerë: Avdi Konjuhi, Festim Kutllovci, Azem Rexha, Ramiz Krasniqi dhe Selvije Kadriu- KPMM; Shahe Kukaj- Krasniqi dhe Fidaim Spahiu - MZHE; Auresa Tafa dhe Arianit Behrami - Zyra e mediave; Liridon Gashi - SEEF; Shpëtim Haziri - GP LDK; Vatra Qehaja - LVV; Valtrim Hasani- KDI; dhe mediat.

Stafi mbështetës i komisionit: Armend Ademaj, Muhamet Morina, Besim Haliti, Veton Raci, si dhe praktikanti Afrim Berisha.

Mbledhjen e kryesoi, Sala Berisha Shala, kryetare e komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 10.4.2019;
3. Shqyrtimi i raportit vjetor të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPMM) për vitin 2018;
4. Shqyrtimi i raportit të performancës së ndërmarrjeve publike qendrore për vitin 2017;
5. Votimi i Vendimit të Qeverisë nr.05/85, datë 22.1.2019, me të cilin autorizohet Komisioni Qeveritar për Privatizimin e Ndërmarrjes Publike “Telekomi i Kosovës SH.A”;
6. Të ndryshme.

Kryetarja konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Dardan Sejdiu propozoi që të hiqet nga rendi i ditës pika e 5-të: “*Votimi i Vendimit të Qeverisë nr.05/85, datë 22.1.2019, me të cilin autorizohet Komisioni Qeveritar për Privatizimin e Ndërmarrjes Publike “Telekomi i Kosovës” S.H.A.*”, për disa arsye, por më kryesorja është që kemi një komision hetimor parlamentar, i cili është duke bërë një punë sa i përket Telekomit të Kosovës dhe nuk mendoj se mund të ecim tutje, pa e parë raportin final të komisionit hetimor parlamentar. Për momentin, këto dy iniciativa bien ndesh me njëra tjetrën, sepse si të privatizojmë diçka, kur është në hetim. Po ashtu, edhe vlera e asetit në kuptimin logjik menjëherë zhvlerësohet.

Memli Krasniqi theksoi se nuk pajtohet me propozimin e deputetit Dardan Sejdiu, sepse duhet vendosur në votim pika 5 edhe pse jo, me u refuzuar. Nuk i shoh domosdoshmërisht të lidhura këto dy procese, edhe kërkesa e Qeverisë, sipas arsyetimit që ka ardhur nga ministria ndërlidhet me një marrëveshje që ata e kanë edhe me Bankën Evropiane për Zhvillim dhe Rindërtim, e cila pa e pasur një vendim nga ana e Kuvendit, nuk mund të ecë tutje në mbështetjen financiare të procesit të ristrukturimit të Telekomit të Kosovës. Edhe shpjegimet që na i ka dhënë ministri këtu, në rastin më të mirë privatizimi i Telekomit, sipas këtij procesi, mund të ndodhë diku pas dy vitesh. Komisioni hetimor e kryen punën në dy muajt e ardhshëm dhe do të dalë me një raport, dhe pastaj varet nga hapat e tjerë që mund t’i ndërmarrë Kuvendi i Kosovës.

Muharrem Nitaj theksoi që secili nga deputetët i ka argumentet e veta, mirëpo ishte i qartë deklarimi i deputetit Sejdiu, se nuk merr pjesë në votim dhe nuk e voton rendin e ditës, nëse nuk hiqet pika 5. Pra, është mocion dhe të nxirret në votim, me propozimin e deputetit Sejdiu, që të shkojmë tutje.

Rendi i ditës u miratua me ndryshimin e propozuar nga deputeti Dardan Sejdiu, që të hiqet pika e pestë.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 10.4.2019

Procesverbali i mbledhjes së datës 10.4.2019, u miratua pa vërejte.

3. Shqyrtimi i raportit vjetor të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPMM) për vitin 2018

Kryetarja theksoi se për sot e kemi në shqyrtim raportin vjetor të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale për vitin 2018, dhe për të prezantuar këtë raport, i kemi ftuar përfaqësuesit e KPMM-së. Ajo potencoi se veprimtaria minerare në Republikën e Kosovës rregullohet me Ligjin nr.03/L-163 për miniera dhe minerale, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr.04/L-158. KPMM rregullon aktivitetet minerare në Kosovë, në përputhje me këtë legjislacion, aktet nënligjore, dhe Strategjinë minerare. KPMM, po ashtu, është përgjegjëse për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr.05/L-062 për sigurinë në punë në veprimtarinë minerare. Për të prezantuar raportin, kryetarja ia dha fjalën kryesuesit të KPMM-së, z.Musa Shabani.

Musa Shabani (KPMM), theksoi se raporti i punës së KPMM-së për vitin 2018 është i formatuar mbi bazën e formatit për raportimet e agjencive të pavarura në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Industria minerare, në vitin 2018, krahasuar me vitin paraprak, ka arritje të rezultateve pozitive, sa i përket licencimit, dhe një rënie, sa i përket mbledhjes së buxhetit. Raporti i punës përmban punën dhe aktivitetin e KPMM-së, në të gjitha fushat dhe duke marrë në konsideratë edhe rekomandimet e dala, gjatë monitorimit dhe vlerësimit të punës së KPMM-së nga komisionet parlamentare dhe auditori kombëtar. Brenda vitit 2018, lëndë minerare, të shfrytëzuara sipas kategorive janë: minerale metalike, Pb-Zn (173,243.96 tonë); Ni-Co (431,630.06 tonë); minerale energjetike (lignit) 7,169,767.00 tonë). Gjatë vitit 2018, Bordi i KPMM-së ka mbajtur 32 takime të rregullta të tij, në të cilat janë shqyrtuar 283 kërkesa për licenca dhe leje. KPMM, gjatë vitit 2018, ka pranuar gjithsej 270 kërkesa për licenca dhe leje, ndërsa janë lëshuar 218 licenca dhe leje, ku hulumtim janë 97, shfrytëzim 39 dhe leje për aktivitet të veçantë 82. KPMM ka refuzuar për mospërmbushje të kushteve për licencim, 63 kërkesa për licenca dhe leje, prej tyre, hulumtim 35, shfrytëzim 14 dhe leje për aktivitet të veçantë 21. Inspektorati i KPMM-së, gjatë vitit 2018, ka pasur një dinamikë të lartë pune të vizitave ose inspektimeve në terren. Në këtë vit, janë përcjellë 91 kallëzime penale në prokuroritë kompetente, në bazë të raporteve që kanë ardhur nga terreni, për operime pa licenca dhe janë në procedurë të shqyrtimit nga gjykatat kompetente. KPMM, gjatë vitit 2018, ka përgatitur 93 Aktvendime për Gjyba administrative lidhur me operimet e pa licencuara, duke respektuar ligjet dhe normat ligjore në fuqi, si dhe 116 propozime janë për përmbardim. KPMM

edhe gjatë kësaj periudhe ka vazhduar të bashkërendis aktivitetet me shumë institucione tjera, lidhur me një menaxhim më të mirë të sektorit minerar, duke përfshirë këtu të gjitha inspektoratet e komunave, Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Policinë si dhe Agjencinë e Pyjeve të Kosovës. Si sfida për arritjen e objektivave të parapara në të ardhmen, janë: reforma në sektorin minerar përmes ndryshimeve ligjore, sepse është hartuar ligji i ri, por ende nuk është miratuar në Kuvend; ngritja e kualitetit dhe sigurisë në punë, në operimet minerare; vonesat në trajtimin e lëndëve të paraqitura në gjykata; problemet me ekonominë joformale në sektorin minerar dhe bashkëpunimi ndër-institucional; inkasimi i borxheve; realizimi i planit për menaxhimin e resurseve minerale; harmonizimi i ligjeve tjera me Ligjin për miniera dhe minerale, siç është rasti me Ligjin për pyjet. Në fund, ai potencoi se nga ajo që ishte në të kaluarën, sot, sektori i minierave në Kosovë është në një stad më të avancuar.

Kryetarja, lidhur me ligjin e ri për miniera dhe minerale, theksoi se në leximin e dytë janë votuar të gjitha amendamentet që e avancojnë sektorin minerar, sa i përket infrastrukturës ligjore, mirëpo disa nga deputetët e Kuvendit të Kosovës, natyrisht edhe nën ndikimin e grupeve të caktuara të interesit, të cilat nuk janë të interesuara të zhvillojnë këtë sektor, po e pengojnë dhe po abstenojnë në votim dhe nuk po e merr numrin e votave të mjaftueshme për miratim të ligjit, në tërësi. Ky ligj është duke u sjellë që një vit, në secilën seancë të Kuvendit. Në vazhdim, kryetarja i parashtrroi disa pyetje dhe komente për përfaqësuesit e KPMM-së, si në vijim: A është i mbuluar plotësisht sektori minerar me ligje dhe akte nënligjore? A po respektohet kohëzgjatja e licencave, siç është përcaktuar në ligj? A janë lëshuar licenca për shfrytëzim zejtar për minerale ndërtimore? Cilat është natyra e arsyeve të refuzimit të kërkesave për licenca dhe leje në përgjithësi? Pse po ndodh realizim i ulët i shfrytëzimit të mineraleve metalore dhe jo metalore, krahasuar me planifikimet? Si janë nxjerrë këto të dhëna dhe a ka rrezik që këto minerale të shfrytëzohen, por mos të deklarohen për t'i ikur pagesave të rentës minerare? Do të ishte e nevojshme të paraqitej në raport, pse janë rikultivuar pjesërisht, pse disa

të tjera nuk janë rrikultivuar? A ka raste që nuk bëhet fare kërkesë për rrikultivim dhe operatori minerar, pas shfrytëzimit e lë sipërfaqen të parikultivuar? Çështja e inspektimit do të duhej të kishte përfshirje më të gjerë, në raport me qasjen analitike e jo vetëm statistikore, duke bërë krahasime të inspektimeve me vitet e kaluara dhe ndikimi në parandalim të aktiviteteve të jashtëligjshme. A është arritur koordinimi institucional, në parandalimin dhe ndalimin e operimeve të jashtëligjshme? Nëse nuk është arritur koordinimi institucional, ku janë pengesat që nuk po arrihet ky koordinim institucional? Kur pritet që të bëhet një koordinim më i mirë që të ndalohen operimet ilegale? A është e mjaftueshme korniza ligjore ekzistuese, për t'i parandaluar operimet ilegale, por edhe për ta zhvilluar sektorin minerar dhe çfarë veprimesh tjera mendoni se mund të ndërmerren, në rast të neglizhimit të përgjegjësive nga institucionet tjera? Ajo, në fund, kërkoi nga përfaqësuesit e KPMM-së, ta elaborojnë kërkesën e tyre të dërguar tash së fundi në komision dhe të sqarojnë, ku qëndron problemi.

Dardan Sejdiu, pyeti: Çfarë lloj aktivitetesh janë operimet ilegale? A ka ndonjë rajon gjeografik, ku aktivitetet ilegale janë më të theksuara?

Memli Krasniqi, pyeti: Ku qëndron problemi që plani për ONE STOP SHOP nuk po funksionalizohet ende? Si mund t'ju ndihmojmë për ta shtyrë këtë proces? Po ashtu, edhe investitorët e huaj kur po vijnë po kanë shumë sfida lidhur me marrjen e licencave dhe kohëzgjatjen e licencave, sidomos licencat nga Agjencia e Pyjeve, të cilat janë të kufizuara në pesë vite dhe në pesë hektarë. A keni komunikuar që ta shihni mundësinë, qysh ta trajtoni këtë problem, që të gjeni një zgjidhje deri në miratimin e ligjit të ri?

Musa Shabani (KPMM), duke u përgjigjur në pyetjet e deputetëve, theksoi se funksionalizimi i ONE STOP SHOP, varet nga miratimi i ligjit të ri për miniera dhe minerale, pasi që me këtë ligj është paraparë edhe krijimi i ONE STOP SHOP, për sektorin minerar. Për ONE STOP SHOP, kemi diskutuar me ministrinë dhe komunat dhe kanë pajtim krijimin e tyre. Edhe kohëzgjatja e licencave, vërtet është sfidë dhe i dekurajon investitorët. Sipas Ligjit për miniera dhe minerale, licencat janë afatgjate, por fatkeqësisht ekziston një udhëzim administrativ i Ministrisë së Bujqësisë, i cili nuk lejon Agjencinë e Pyjeve të Kosovës (APK), të japë në shfrytëzim sipërfaqe me më shumë se 5 hektarë dhe me kohëzgjatje më shumë se 5 vite. Kjo kufizon shumë mundësitë e zhvillimit të sektorit minerar modern, siç është në vendet e zhvilluara. Kemi biseduar me APK-në dhe kemi kërkuar ndryshimin e këtij udhëzimi administrativ, por ata kanë thënë se është në procedurë ndryshimi i ligjit, komentet tona i kanë inkorporuar, por edhe ai ligj ka mbetur ende i pamiratur. Operimet ilegale, kryesisht janë në zonat rreth lumenjve dhe shtrihen në rajonin e Pejës, Gjakovës, Prizrenit dhe Kamenicës. Licenca për zhavorr rreth lumenjve nuk ka. Ne i zbatojmë ligjet në fuqi, por ka nevojë për reforma ligjore, të cilat janë propozuar me ligjin e ri, që pritet të miratohet. Kryesisht, kohëzgjatja e licencave për hulumtim, respektohet. Te mineralet metalore, të gjithë të licencuarit për hulumtime nuk kanë aplikuar ende për licencë, për shfrytëzim. Vetëm një është në mbajtje të të drejtave të licencës. Licencat për shfrytëzim zejtar, në shkallë të ulët të mineraleve ndërtimore iu lëshohen komunave, por asnjë komunë nuk ka aplikuar për licencë dhe ka disa që veprojnë, por pa licencë. Natyra e refuzimit të licencave është kryesisht për shkak të mungesës së dëshmive, se posedojnë burime financiare të mjaftueshme për t'u zhvilluar më tutje. Ekziston dukuria e realizimit të ulët të shfrytëzimit minerar, krahasuar me planifikimin dhe e kemi adresuar në MZHE, por MZHE nuk ka qenë e gatshme për të na përkrahur dhe për të bërë një planifikim më të mirë, si dhe për një periudhë, të ndalej dhënia

e licencave. Çdo aktivitet minerar me licencë nuk mund t'iu i ikë rentave minerare, sepse bëhen matje gjeodezike dhe verifikohen ato matje nga KPMM. Lidhur me rikultivimin, ndërmarrja që ka licencë duhet ta ketë edhe projektin e rikultivimit. Pas përfundimit të minierës, një komision ndërinstucional me ministrinë relevante, dalin në terren dhe verifikojnë rikultivimin, dhe pastaj i jepet leja për mbyllje përfundimtare të asaj miniere. Ka raste kur rikultivimi bëhet i pjesshëm, për shkak se rikultivohet gradualisht, varësisht prej shfrytëzimit.

Kryetarja pyeti: A ka kompani të interesuara për mineralet që gjenden në zonat e interesit të veçantë? A ka ankesa nga palët e interesit që ndërlidhen me procedurat e stërzgjatura dhe burokratike në sektorin minerar?

Memli Krasniqi potencoi se nga përgjigjet kuptuam se, siç duket, kompanitë gjatë hulumtimit nuk kanë gjetur ende minerale metalike, që të vazhdojnë me shfrytëzim. Asnjë minierë metalore nuk ka filluar, ku është problemi? A ka minerale metalike në këtë vend? A ka minerale metalike në zonat e interesit të veçantë?

Musa Shabani (KPMM), sqaroi se sa i përket mineraleve metalore, jashtë zonave të interesit të veçantë, formacionet gjeologjike që ndodhen në tokën e Kosovës i kanë edhe premisat për të gjetur edhe minerale metalore. Mirëpo, zonat e interesit që janë shpallur nga Qeveria, janë zona që ka pasur hulumtime para luftës, ku ato hulumtime janë kryer atëherë nga institucionet e ish-Jugosllavisë edhe nga Trepça. Nuk mund të themi që nëse nuk janë gjetur deri sot, nuk do të gjinden në të ardhmen. Metodatat e kërkimit po avancohen dhe kërkesat për minerale metalore janë rritur në botë. KPMM nuk është kompetente për të pranuar aplikacione për zonat e interesit të veçantë. Aplikacionet e tilla bëhen direkt në Qeverinë e Republikës së Kosovës.

Festim Kutillovi (KPMM), shtoi se ka edhe shfrytëzim ilegal të thëngjillit në zonën e Vushtrrisë. Deri në vitin 2017 edhe shkollat kanë blerë thëngjill me origjinë ilegale, mirëpo blerja e thëngjillit për shkolla është ndërprerë. Kufizimi me udhëzim administrativ nga Ministria e Bujqësisë, lejet për sipërfaqe 5 hektarë dhe kohëzgjatje 5 vite, është problem dhe investitorët nuk e shohin të favorshëm për investime. Ne kemi kërkuar ndryshimin e këtij udhëzimi administrativ, por ende nuk e kanë ndryshuar. Sa i përket shitjes së thëngjillit, vetëm KEK-u ka të drejtë të shesë thëngjill.

Musa Shabani (KPMM), lidhur me shkresën që KPMM e ka dërguar dje në Komisionin për Zhvillimin Ekonomik, sqaroi se ka të bëjë me një rast ku Prokuroria e Kosovës ka ngritur hetime ndaj KPMM-së, lidhur me një lëndë të vitit 2013, e cila pastaj ka qenë në gjykatë dhe është kërkuar të rivendosë bordi aktual. Bordi aktual e ka marrë vendimin, në bazë të Ligjit për miniera dhe minerale dhe ka vendosur ta refuzojë vazhdimin e asaj licence, e më pas kompania ka ngritur kallëzim penal. Është fjala për kompaninë “Kosova Metal Resource”.

Pas diskutimeve, komisioni, njëzëri, nxori këtë:

Përfundim

Miratohet raporti vjetor i Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPMM), për vitin 2018.

4. Shqyrtimi i raportit të performancës së ndërmarrjeve publike qendrore për vitin 2017

Kryetarja tha se raporti për performancën e ndërmarrjeve publike qendrore për vitin 2017, është shqyrtuar në një nga mbledhjet e kaluara, ku pas diskutimeve, komisioni ka kërkuar raport shtesë financiar për vitin 2018, në mënyrë që të krahasohet me vitin 2017. Raportin shtesë e kemi marrë dhe sot e kemi në pikë të rendit të ditës, shqyrtimin e raportit të performancës, duke përfshirë raportin financiar për vitin 2018. Më pas, kryetarja ia dha fjalën përfaqësuesit të MZHE-së, z. Adem Ahmetaj.

Adem Ahmetaj, MZHE (NJPMNP), tha se në një nga mbledhjet e kaluara, ministri Lluka ka prezantuar në komision raportin për performancën e ndërmarrjeve publike qendrore për vitin 2017, por është kërkuar nga deputetët të silltet një raport financiar për vitin 2018. Raporti financiar për vitin 2018 është përgatitur, mirëpo është draft i paaudituar, të cilin raport e keni marrë dhe jemi këtu të japim sqarimet e duhura.

Dardan Sejdiu tha se te Telekom i Kosovës, ku janë paraqitur shpenzimet, është thënë: “32 milionë euro shpenzime tjera”. Çka përfshijnë këto shpenzime?

Shahe Kukaj- Krasniqi (MZHE), sqaroi se na është kërkuar një përmbledhje dhe jo të gjitha detajet e shpenzimeve. Ato 32 milionë euro përfshijnë shpenzimet operative.

Pas diskutimeve, komisioni, me 5 (pesë) vota “për” dhe 1 (një) “abstenim”, nxori këtë:

Përfundim

Miratohet raporti i performancës së ndërmarrjeve publike qendrore për vitin 2017.

5. Të ndryshme Çështjet vijuese

Kryetarja njoftoi deputetët se më datë 31 maj 2019, në orën 10:00-12:00, është caktuar takim me Odën Ekonomike Amerikane, në hotel “Nartel”, me kërkesë të tyre, me temë: “Hartimi i politikave, të cilat afektojnë sektorin privat, si dhe zhvillimin ekonomik të vendit në përgjithësi”. Po ashtu, me kërkesë të tyre, në të njëjtën datë, nga ora 13:00 – 14:00, është caktuar takim me Bankën Botërore, në ndërtesën e Kuvendit, me temë: “Reforma në fushën e inspektimeve”.

Mbledhja përfundoi në orën 14:30.

E përgatiti: Staf i mbështetës i komisionit.

Kryetarja e komisionit,

Sala BERISHA SHALA